



Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____/2018

Datë: 23.01.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 51 pika 1 dhe nenit 52 pika 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.03/2014, për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.01.2018, pas diskutimit lidhur me pikën e 2-të të rendit të ditës: Kërkesa e MAPL-së për rishqyrtimin e Vendimit 01 nr. 112/05-190 të dt. 05.01.2017 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Gjakovës prej 9 (Nëntë) anëtarëve, me këtë përbërje:

1. z. Haxhi Sejdiu përfaqësues nga AAK.
2. znj. Florentina Gjergjaj, përfaqësuese nga AAK.
3. znj. Diana Qarkagjija, përfaqësuese nga Alternativa
4. znj. Hana Zeka, përfaqësuese nga Alternativa.
5. z. Bekim Jupa, përfaqësues nga PDK.
6. z. Agon Batusha, përfaqësues nga VV.
7. z. Bekim Ermeni, përfaqësues nga LDK
8. z. Anton Shala, Kryesues i Kuvendit.
9. z. Fazli Hoxha, përfaqësues nga NISMA.

2. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. **Anton Shala**.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës

4. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Shërbimit për pagesa.
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala